



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 27.12.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 22.12.2023 të parashtruar nga Operatori ekonomik “Marisa” sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me “ Ri-tender -Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-13225-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-004 -511, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: “Marisa” sh.p.k., e dt.22.12.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-tender -Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-13225-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-004 -511, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK –së, të datës 24.11.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË e publikuara me datë: 24.11.2023;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “Marisa” sh.p.k., me dt.22.12.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-tender - Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-13225-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-004 -511.

REPUBLIC OF KOSOVA
Municipality of Gjakova

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.12.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se kërkesat e Autoritetit kontraktues për dimensionet dhe peshën janë deskriminuese, është i pabazuar, sepse Autoriteti kontraktues nuk ka vendosur limit fiks për këto kritere dhe është Autoriteti kontraktues ai që vendos kriteret dhe specifikat që mendon se janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të një aktiviteti.

Pretendimi juaj lidhur me mostrat është i pabazuar, sepse Autoriteti kontraktues, ka vepruar konformë Nenit: 37, paragrafët 37.2 dhe 37.6, të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022:

37.2 Kur kërkohen mostrat ato mund të dorëzohen paraprakisht, ose gjatë kohës së mbylljes së tenderit. Ato duhet të dorëzohen para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve.

37.6 Mostrat e kërkuara janë pjesë e tenderëve, dhe ato janë pjesë të testit teknik të nevojshëm për vlerësimin e secilit tender. Si pasojë, testi bëhet pjesë e procesit të vlerësimit, dhe rrjedhimisht kontraktin e përzgjedhur. Mostrat e kompanisë se shpërblyer me kontratë duhet të ruhen nga autoriteti kontraktues për gjatë tërë kohëzgjatjes së kontratës. Për sa i përket tenderuesve jo të suksesshëm, mostrat e tyre mund të kthehen tek ofertuesit (me kërkesë specifike) me kusht që ato ende ekzistojnë fizikisht (në kuptimin që testi nuk ka shkatërruar mostrën) dhe afati për të parashtruar ankese kundër vendimit të marrë nga autoriteti kontraktues për shpërbllim të kontratës ka skaduar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesëankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit
